



## **BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

---

Në bazë të nenit 64 paragrafi 1 pika 22 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 03/02, 51/03, 85/03, 40/04, 61/05 dhe 129/06), dhe në lidhje me nenin 5 paragrafi 1 pika 6 dhe 7 të Ligjit për Qarkullim Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 113/07), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

### **VENDIM**

**për përcaktimin e një standardi për ndërtimin e llogarive të pjesëmarrësve në qarkullim pagesor dhe caktimin e një kodi bankar për bartësit e qarkullimit pagesor**  
**("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 146/07)**

#### **I. Dispozitat e përgjithshme**

1. Ky Vendim përshkruan standardin për ndërtimin e një llogarie transaksioni (në tekstin e mëtejshëm: llogari) të pjesëmarrësit në qarkullim pagesor tek bartësi i qarkullimit pagesor dhe mënyrën e caktimit të një numri drejtues për bartësin e qarkullimit pagesor.

2. Nëpërmjet llogarive të transaksioneve të ndërtuara në përputhje me këtë Vendim, bartësit e qarkullimit pagesor realizojnë pagesa në denarë në qarkullimin pagesor.

#### **II. Standardi për ndërtimin e llogarisë**

3. Bartësi i qarkullimit pagesor e ndërton numrin e llogarisë me ndarjen e gjithsej pesëmbëdhjetë (15) shifrave, prej të cilave:

- 3.1. tre (3) shifrat e para janë numri drejtues i bartësit të qarkullimit pagesor;
- 3.2. dhjetë (10) shifrat në vijim janë numri i llogarisë së pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor brenda sistemit të bartësit të qarkullimit pagesor; dhe
- 3.3. dy (2) shifrat e fundit janë numër kontrolli.

3.1. Kodi bankar i bartësit të qarkullimit pagesor

Kodi bankar shërben për të identifikuar bartësin e qarkullimit pagesor.

Kodi bankar i bartësit të qarkullimit pagesor jepet nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë me lëshimin e licencës për themelim dhe operim, si një numër unik dhe të papërsëritshëm për çdo bartësit të qarkullimit pagesor. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë mban dhe publikon Listë të numrave udhëheqës të bartësve të qarkullimit pagesor në faqen e internetit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë.

3.2. Numri i llogarisë së bartësit të qarkullimit pagesor

Numri i llogarisë brenda sistemit të bartësit të qarkullimit pagesor shërben për të identifikuar pjesëmarrësin në qarkullimin pagesor.

Numri i llogarisë së bartësit të qarkullimit pagesor duhet të jetë unik dhe i papërsëritshëm për secilën llogari brenda sistemit të bartësit të qarkullimit pagesor.

### 3.3. Numri kontrollues

Numri kontrollues llogaritet sipas standardeve ndërkombëtare ISO 7064 duke përdorur sistemin "modul 97-10".

## **III. Dispozita klaimtare**

4. Kodet bankare të bartësve të qarkullimit pagesor që janë dhënë deri në datën e zbatimit të këtij Vendimi dhe të publikuara në Listën e kodeve bankare të bartësve të qarkullimit pagesor vazhdojnë të jenë të vlefshëm.

## **IV. Dispozitat përfundimtare**

5. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe zbatohet nga 1 janari i vitit 2008.

6. Me ditën e zbatimit të këtij vendimi, pushon së qenuri i vlefshëm Vendimi për përcaktimin e standardit për ndërtimin e llogarive të pjesëmarrësve në qarkullimin pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/01) dhe Vendimi për ndarjen e kodit bankar të bartësve të qarkullimit pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 138/06).

Përpunuar më 02-15/XI-5/2007  
29 nëntor 2007  
Shkup

Kryetar  
i Këshillit të Bankës Popullore të Republikës  
së Maqedonisë  
Governator  
m-r Petar Goshev